



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 13.7, 15.1, 16.2, 19.2 dhe 33 të Ligjit për planifikimin hapësinor nr. 2003/14, të datës 3.7.2003, dhe të nenit 16 par. 1, shkronja **b** dhe neni 32 të Statutit të Komunës së Prishtinës, të dt. 31.3.2008, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 16.7.2008, merr

V E N D I M
PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT RREGULLUES
“QYTEZA PEJTON” NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues “Qyteza Pejton ” në Prishtinë.

Neni 2

Qëllimi i nxjerrjes së Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, është rregullimi i hapësirës dhe urbanizimi, sipas destinimeve të planifikuara me Planin strategjik-zhvillimor urban i Prishtinës, të miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunës të Prishtinës nr. 01-031-1231/1 dt. 02.07.2004, brenda kufijve të përshkruar në nenin 3 të këtij Vendimi.

Neni 3

Me Planin rregullues, nga neni 1 i këtij Vendimi, do të përpunohet hapësira e territorit të qytetit të Prishtinës, e emërtuar “ Qyteza Pejton”, e cila përkufizohet: në anën verilindore me rrugën “Garibaldi”, në anën lindore me rr. “Nënë Tereza”, vazhdon përgjatë rrugës “Perandori Justinian” deri te rr. “Bill Klinton” në jug perendim, dhe në anën veriperendimore vazhdon përgjatë rrugës “Robert Dol” – kufiri i Planit rregullues “Lakërishta” deri në pikëtakimin me rr. “Kosta Novaković”, duke përfshirë një sipërfaqe prej 20 ha.

Kufijtë e përshkruar të hapësirës nga par.1 i këtij neni, janë të paraqitur në pjesën grafike, e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Bartësi i detyrave programore dhe hartimit të Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, do të përcaktohet përmes procedurës së tenderimit.

Drejtoritë tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, janë të obliguara që të sigurojnë dhe dërgojnë shënimet e kërkuara nga Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtje së Mjedisit, për të cilat konsiderohet të jenë të nevojshme për hartimin e Planit rregullues sipas këtij Vendimi.

Neni 5

Mjetet financiare për hartimin e Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, do të sigurohen nga buxheti i Komunës së Prishtinës.

Neni 6

Plani rregullues, sipas këtij vendimi, do të miratohet me vendimin e Kuvendit të komunës së Prishtinës, si projektplan, në mënyrë që ai t'i nënshtrohet diskutimit publik para finalizimit dhe miratimit përfundimtar të tij.

Derisa të bëhet miratimi përfundimtar i Planit rregullues për hapësirën e përkruar në nenin 3 të këtij Vendimi, kërkesat e qytetarëve për zhvillim të punimeve do të zgjidhen përmes dhënies së pëlqimit në lokacion, me mundësin e inkorporimit të lokacionit përkatës në Planin rregullues të këtij kompleksi.

Neni 7

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Këshilli i Drejtorëve i Komunës së Prishtinës.

Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01 Nr.35-1014, më 16.7.2008

KRYETARI I KOMUNËS

Prof. dr. Isa Mustafa